REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr._____prot. Lushnjë, më ____/_____/ 2025

MIRATOHET
KRYETAR
Eriselda Sefa

UDHËZUES I BRENDSHËM

"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Sjelljen Etike në Vendin e Punës"

Qëllimi

Ky udhëzues ka për qëllim të garantojë integritetin, transparencën dhe profesionalizmin në ushtrimin e detyrave nga çdo punonjës i Bashkisë Lushnjë, duke parandaluar konfliktin e interesit dhe duke promovuar sjelljen etike në vendin e punës.

I. *Parimet Kryesore*
Punonjësit e Bashkisë Lushnjë duhet të ushtrojnë detyrën duke respektuar këto parime:

- Paanshmërinë dhe barazinë ndaj qytetarëve;
- Transparencën dhe përgjegjshmërinë;
- Ndershmërinë dhe integritetin profesional;
- Respektin reciprok në marrëdhëniet e punës;
- Ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit zyrtar;
- Zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

II. Konflikti i Interesit
Çfarë konsiderohet konflikt interesi?
Konflikti i interesit lind kur interesat private të punonjësit ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen e paanshme të detyrës publike si:
Përfshirja në vendimmarrje për familjarë ose persona të afërt;
Përfitimi personal nga informacionet zyrtare;
Pranimi i dhuratave ose favoreve që ndikojnë në vendimmarrje;
Përdorimi i pozicionit për interesa private;
Angazhimi në aktivitete private që cenojnë detyrën publike.

Detyrimet e punonjësve:
Të deklarojnë menjëherë çdo rast të mundshëm konflikti interesi;
Të shmangin pjesëmarrjen në vendimmarrje në rast konflikti;
Të respektojnë rregullat e etikës dhe integritetit institucional.

III. Sjellja Etike në Vendin e Punës
Punonjësit duhet:
Të komunikojnë me etikë dhe respekt me kolegët dhe qytetarët;
Të shmangin gjuhën fyese, diskriminuese ose denigruese;
Të ruajnë korrektësinë dhe seriozitetin gjatë orarit të punës;
Të bashkëpunojnë për krijimin e një klime pozitive pune;
Të përdorin me përgjegjësi asetet dhe pajisjet institucionale.

IV. Dhuratat dhe Përfitimet
Punonjësit nuk duhet të pranojnë:
Dhurata me vlerë monetare;
Përfitime personale që lidhen me ushtrimin e detyrës;
Ftesa apo favore që ndikojnë në paanshmërinë e tyre.
Përjashtohen vetëm dhuratat simbolike ose protokollare, sipas legjislacionit në fuqi.

V. Raportimi i Shkeljeve
Çdo punonjës ka të drejtë dhe detyrim:
-Të raportojë raste të konfliktit të interesit;
-Të raportojë sjellje joetike ose abuzive;
-Të kontribuojë në ruajtjen e integritetit institucional.
-Raportimet trajtohen me konfidencialitet dhe në përputhje me procedurat administrative.

VI. Masat Administrative
Mosrespektimi i këtij udhëzuesi sjell:
1.Masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi;
2.Përgjegjësi administrative ose ligjore, kur është e nevojshme.

VII. Dispozita Përfundimtare

Ky udhëzues shërben si dokument orientues për të gjithë punonjësit e Bashkisë Lushnjë dhe synon forcimin e kulturës së integritetit, etikës dhe përgjegjshmërisë në administratën publike.
Bashkia Lushnjë.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

ERISA QALLIU